



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General
Secretary

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 19/2018 Për Themelimin dhe Funksonimin e Qendrave mësimore, nxjerr:

V E N D I M

Për regjistrimin e qendrave mësimore

1. OJQ “Balkan Sunflowers Kosovo” në Fushë Kosovë, i jepet leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë në qendrën mësimore me bazë në komunitet – FKLC Fushë Kosova learning Center “Fidan Lahu” për periudhën njëvjeçare, prej dt. 20.08.2021 deri me dt. 19.08.2022, me mundësi për riaplikim pas sigurimit të një objekti të sigurt.
2. OJQ “Balkan Sunflowers Kosovo” në Fushë Kosovë me bazë në komunitet – FKLC Fushë Kosova, ushtron funksionin e saj konform Udhëzimit administrativ nr. 19/20218 Për Themelimin dhe Funksonimin e Qendrave Mësimore.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, bazuar në aplikimin dhe dokumentacionin e ofruar në formë elektronike nga qendra mësimore FKLC Fushë Kosovë, Learning center” në Fushë Kosovë,, për ushtrimin e veprimtarisë në qendrën mësimore me bazë në komunitet – FKLC Fushë Kosova learning Center “Fidan Lahu”, raportin e Komisionit për regjistrimin e qendrave mësimore të cilat mbështesin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian; hapësirat ku ushtrohet veprimtaria në parim nuk janë për objekte standarde arsimore dhe janë hapësira të kufizuara, prandaj lejohet që të mësohet me numër të kufizuar në qendrën mësimore me bazë në komunitet. Niveli parashkollor dhe niveli fillor 1-5, puna me nxënës në të njëjtat objekte duhet të mbahet me numër të kufizuar në dhoma me grupe nga 10 nxënës, në 3 ndërrime me gjithsej 30 nxënës, dhe në funksion të zbatimit të Udhëzimit administrativ nr. 19/20218 Për Themelimin dhe Funksonimin e Qendrave mësimore si dhe bazuar në udhëzuesin për norma dhe standarde të ndërtesave shkollore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. OJQ-së “Balkan Sunflowers Kosovo” Fushë Kosova;
2. Zyrës së SP;
3. Div.ars. të komuniteteve;
4. Arkivit.

Fadile Dyla
Zv. sekretare e përgjithshme